



Bashkia Korçë



Raporti Performancës 2021



Shënim i rëndësishëm

Dokumenti bazohet në të dhënat e konsoliduara të zbatimit të buxhetit për vitin 2021 të cilat janë pjesë e Buxhetit Interaktiv – Fakt 2021 të Bashkisë Korçë.

[Korce - Raporti i Performances 2021 | Tableau Public](#)

Ky dokument është prodhuar nga Bashkia Korçë me asistencën e Projektit Bashki të Forta një Projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC dhe grupin Teknik të Shapo Consulting.

Përmbajtja

Fjalor shpjegues.....	3
Zhvillimet kryesore gjatë vitit 2021	4
Burimet e Financimit	5
Shpenzimet buxhetore	6
Investimet	7
Administrimi i bashkisë	8
Shërbime publike vendore.....	10
Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor	11
Menaxhimi i mbetjeve	13
Sport dhe argëtim	15
Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore.....	18
Ndriçim rrugësh	19

Fjalor shpjegues

Taksat e ndara

Janë taksa kombëtare që mblidhen nga qeveria qendrore dhe ndahen plotësisht ose pjesërisht me bashkitë

Tasat vendore

Janë detyrime fiskale të bashkisë të cilat paguhen sipas parashikimeve ligjore dhe përcaktimeve të Këshillit Bashkiak

Tarifat vendore

Janë detyrime që individët apo bizneset paguajnë kundrejt marrjes së një shërbimi të ofruar nga bashkia

Transfertat e kushtëzuara

Janë fonde që Qeveria Qendrore (buxheti i shtetit) i jep bashkisë për t'u përdorur vetëm për projekte të veçanta apo funksione të deleguara të bashkisë

Transfertat e pakushtëzuara

Janë fonde që Qeveria Qendrore (buxheti i shtetit) i jep bashkisë për t'u përdorur pa kushte, pa interes dhe pa të drejtë kthimi

Transfertat specifike

Janë fonde që Qeveria Qendrore (buxheti i shtetit) i jep bashkisë me kushtin për t'u përdorur vetëm për funksione specifike që bashkia i ka marrë nga Qeveria me ligj të veçantë

Trashëgimi nga viti kaluar

Janë fonde buxhetore të bashkisë të cilat nuk janë shpenzuar në mbyllje të vitit buxhetor të kaluar dhe mund të përdoren në vitin korent buxhetor. Ato mund të jenë me destinacion dhe pa destinacion. Varësisht nga kjo ato mund të përdoren gjatë vitit korent me destinacion të përcaktuar (për ato projekte apo zëra buxhetor specifik për të cilat janë angazhuar gjatë vitit të kaluar por nuk kanë arritur të shpenzohen) apo pa destinacion (për çfarëdo zëri apo projekti buxhetor).

Nocione dhe mënyra e llogaritjes së disa treguesve të përdorur në këtë raport

Tregues të performancës së programeve buxhetore. Ndryshe treguesit e performancës së shërbimeve që ofron bashkia për komunitetin e saj. Tregojnë se çfarë është realizuar me fondet buxhetore të buxhetit të bashkisë (qofshin ato nga burimet e saj të financimit apo nga QQ) si përshebull: zgjerimi i rrjetit rrugor, bërja funksionale e kanaleve kulluese apo vaditëse, shtimi i fondit pyjor apo kullosor, rritja e frekuentimit të nxënësve në institucionet e arsimit bazë dhe atij parashkollor etj.

Shenja të përdorura në raport dhe leximi i tyre

Përmirësim



Përkeqësim



E njëjta situatë



Nuk ka informacion



Zhvillimet kryesore gjatë vitit 2021

Bashkia Korçë

Bashkia Korçë arriti të mbyllë me sukses një vit ende të vështirë ku pasojat e pandemisë botërore nuk ishin të lehta. Ekonomia vendore në të gjithë sektorët përveç bujqësisë dhe ka pësuar rënie. Më së shumti efektin e pandemisë e kanë ndjerë biznet e vogla kryesisht ato deri në 5 milionë lekë xhiro në vit. Shërbimet edhe pse nën ndikimin e rënies së volumit të xhiros duke u krahasuar me vitin 2020, kur pothuajse u mbyllën totalisht njësitë e hoteleve dhe bar-restoranteve, e rimorën disi veten në vitin 2021. Bizneset e mëdha kanë pasur një efekt negativ disi më të amortizuar. Në tërësi bizneset pësuan rënie në prodhim e shërbime e për rrjedhojë rënien e fitimit të cilat çuan në rënien e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore që mbledh bashkia për bizneset e shërbimeve. Bashkia karakterizohet nga prodhimi bujqësor sektor ky shumë pak i prekur nga pandemia, kjo reflektohet në faktin që të ardhurat nga taksat, tarifat dhe gjithë burimet e vendore të bashkisë janë rritur me rreth 29% krahasuar me vitin 2020. Rritjen më të madhe e kanë pasur të ardhurat nga taksat e ndara.

Buxheti i bashkisë në fund të vitit 2021 rezulton të ketë alokuar rreth 26% më pak fonde sesa një vit më parë duke shtuar reflektuar kështu financimin e projekteve të financuara nga qeveria qendrore, të cilat vazhdojnë të jenë të larta për bashkinë Korçë por disi më të vogla përgjatë vitit 2021.

Përgjatë vitit 2021 financat e bashkisë janë karakterizuar nga:

- ✿ Rënia e fondeve për investime me rreth 29% kundrejt një viti më parë
- ✿ Mbështetje me shërbime publike dhe arsim bazë duke zënë një peshë nga më të lartat në buxhetin e bashkisë
- ✿ Ruajtjen e numrit të personelit të bashkisë
- ✿ Rritja e peshës së të ardhurave të veta në totalin e burimeve të financimit të bashkisë.

Ekzekutimi i buxhetit ka arritur të përdorë pjesën më të madhe të burimeve të financimit, gjithësesi është mbullur me një shumë mbi 100 milionë lekë të paekzekutuara nga tërësia e fondeve të disponueshme deri në fund të vitit buxhetor.

Burimet e Financimit

TË ARDHURAT SIPAS BURIMIT (Në mijë Lekë)		FAKT 2019	FAKT 2020	FAKT 2021	PLAN 2021	REALIZIMI në %
		2,402,810	2,133,249	2,288,070	2,569,500	89%
Kategoria	Burimi buxhetor	Fakt 2018	Fakt 2019	Fakt 2021	Plan 2021	Fakt Vs Plan 2021 në %
TË ARDHURA NGA BURIMET E VETA	Të ardhura nga taksat e ndara	66,394	42,582	89,264	59,200	65%
	Të ardhura nga taksat lokale	242,294	185,557	309,005	474,382	151%
	Të ardhura nga tarifa vendore	334,758	324,696	345,751	434,219	80%
	Të ardhurat e tjera	38,286	23,184	1,559	45,047	4%
TË ARDHURA NGA BUXHETI QENDROR	Transferta e kushtëzuar	680,732	646,377	612,653	626,814	98%
	Transferta e pakushtëzuar	439,016	449,034	453,082	453,082	100%
	Trashëgimi nga viti i shkuar	293,882	154,039	135,673	135,673	100%
	Transferta e pakushtëzuar sektoriale + tr specifike			341,083	341,083	100%





Figura 1. Peshë e burimit të financimit në totalin e të ardhurave të bashkisë

Bashkia vazhdon të këtë një financim që varet nga transfertat e qeverisë qendrore. Të ardhurat nga burimet e veta të financimit janë ende të vogla. Burimet e financimit u karakterizuan nga:

- ✿ Të ardhurat e përgjithshme të bashkisë janë rritur me rreth 7% kundrejt vitit 2020 dhe u realizuan në masën 89% të planit për vitin 2021
- ✿ Peshë e të ardhurave të veta (taksat dhe tarifatat) në total burime financimi është 33% dhe transfertat e qeverisë është 61%
- ✿ Të ardhurat e veta u rritën me 29%
- ✿ Të ardhurat e qeverisë ishin pothuajse në të njëjtin nivel sikurse në vitin 2020
- ✿ Realizimin më të lartë e kanë taksat e ndara në tërësinë e gjithë burimeve të financimit. Ato u realizuan në masën 151% të planit (tejkalar plani me 51%).

Shpenzimet buxhetore

SHPENZIMET SIPAS PROGRAMIT (Në mijë Lekë)	FAKT2019	FAKT 2020	FAKT 2021	PLAN 2021	REALIZIMI NË %
	2,248,773	1,997,576	1,484,215	1,674,155	89%




Dy fjalë mbi shpenzimet

Shpenzimet buxhetore për vitin 2021 shënuan rënie kundrejt vitit 2020 me gati 26%, jo për shkak të burimeve të financimit por për shkak të pamundësisë për t'i alokuar fondet sipas parashikimeve në kohë, ndërkohë që realizimi i tyre kundrejt planit të vitit 2021 ishte rreth 89%. Bashkia ofron një numër të madh shërbimesh për popullatën duke filluar nga administrimi i pyjeve dhe kullotave e deri tek shërbimet e kujdesit social. Peshën më të madhe të financimit nga buxheti i bashkisë e zënë shërbimet e mëposhtme për të cilat bashkia raporton më poshtë edhe në lidhje me performancën e shërbimeve të ofruara nga ato. Kryesisht realizim 100% të planit e kanë shërbimet që kanë një financim pothuajse tërësor nga transfertat e qeverisë qendrore si për shërbimet e kujdesit social.

- ✿ *Administrimi i bashkisë*
- ✿ *Sport dhe argëtim*
- ✿ *Shërbime publike vendore*
- ✿ *Trashëgimia kulturore*
- ✿ *Arsimi bazë përfshirë parashkollor*
- ✿ *Ndriçim rrugësh dhe menaxhimi mbetjeve*

Investimet

INVESTIMET SIPAS PROGRAMEVE /Shërbimeve (Në mijë Lekë)	FAKT 2019	FAKT 2020	FAKT 2021	PLAN 2021	REALIZIMI 2021 në %
	481,752	149,166	106,084	291,221	36%



Dy fjalë mbi realizimin e investimeve

Bashkia ka investuar për përmirësimin e shërbimeve publike një fond prej 106 milionë Lekë. Kundrejt vitit 2020 investimet kanë rënë me 29% kjo shpjegon kontributetin e tyre ende modest në buxhet. Ndërkohë që realizimi i investimeve për vitin 2021 kundrejt planit është në masën 36%.


Investimet e bashkisë gjatë vitit 2021 karakterizohen nga:

- ✿ Ato kanë zënë në fund të vitit 2021 rreth 7% të buxhetit të bashkisë, pothuajse të njëjtën peshë sikurse në vitin 2020

Projektet e investimeve kanë synuar përmirësimin e shërbimeve si: rikonstruksion të shkollave 9-vjeçare si ajo në Voskopojë, Nuçi Naçi; pyllëzim i kurorës së qytetit Korçë, në Voskopojë dhe në Moravë; përmirësimin e banesave të familjeve në nevojë; rikonstruksion i rrugëve si: Koço Glozheni në Dardhë, Voskopojë-Vithkuq; Rikonstruksion i pallatit të Sportit Tamara Nikolla; ndërtimi i pritave malore për sistemin e kanaleve kulluese dhe vaditëse etj.

Administrimi i bashkisë

Realizimi faktik 2021	Vlera në mijë Lekë	Pesha ndaj totalit në %	Realizimi Faktik 2021
	93,793	6%	81%



Qëllimi i programit buxhetor

Rritja e kapaciteteve të administratës dhe qëndrueshmërisë së saj për të ofruar shërbime më të mira për komunitetin

Figura 4: Kategoritë e shpenzimeve për programin Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi: korente dhe investim

Trendi	Objektivat dhe Treguesit e Performancës	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
↓	Masa disiplinore të marra nga stafi bashkisë (ndryshimi në % kundrejt vitit të kaluar)	-11	-3	5	7
↓	Numri i punonjësve që kanë lëvizur brenda vitit kundrejt numrit total të punonjësve (raporti në %)	1.81	6.44	8.00	2.25
↑	Raporti i numrit total të ditëve të trajnimeve kundrejt numrit total të personave të trajnuar (mesatarisht ditë trajnimi për person në vit)	0.14	0.21	6.00	0.33

Produkte	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
Ditë trajnimi në total	26	50	126	80
Numri total i personave të trajnuar	189	233	21	240

Të dhëna	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
Numri total i punonjësve të bashkisë	995	1,025	1,025	1,066
Numri i punonjësve që kanë lëvizur brenda vitit	18	66	82	24
Masa disiplinore të marra nga stafi bashkisë	8	5	10	12
Numri total i punonjësve të administratës së bashkisë	995	1,025	1,025	1,066
Fondi vjetor i pagave të punonjësve të bashkisë Në mijë lekë	748	777	776	814
Shpenzime për investime Në mijë lekë	2,588	0	5,304	8,217
Numri total i punonjësve ne njesite shpenzuese	748	777	776	814
Shpenzime korente Në mijë lekë	162,277	103,790	88,489	107,646

Performanca e shërbimit


Bashkia ka realizuar shpenzime për shërbimet mbështetëse për kryetarin e bashkisë, këshillin bashkiak, mbajtjen dhe përditësimin e informacionit, komunikimin me publikun dhe ofrimin e funksioneve të parashikuara me ligj nga administrata e bashkisë në masën 81% të planit 2021. Bashkia shpenzon rreth 6% të buxhetit për administratën. Në këtë program regjistrohen punonjësit, shpenzimet për ta dhe investime që kanë të bëjnë edhe me shërbime të tjera të cilat nuk janë regjistruar si funksione më vehte të bashkisë. Investimet për administratën kanë qenë të pakta gjatë vitit 2021 duke reflektuar kështu prioritetet e tjera që ka pasur gjatë këtij viti përshkak të pandemisë. Performanca e administratës së bashkisë gjatë vitit 2021 tregon se:

- ✿ Janë marrë më shumë masa disiplinore për punonjësit e bashkisë, duke vënë në dukje shtimin e kontrollit të bashkisë për respektimin e kuadrit ligjor dhe rregulloret e administratës.
- ✿ Për rrjedhojë është rritur numri i personave që kanë lëvizur nga puna, duke ulur qëndrueshmërinë e administratës.
- ✿ Ka vazhduar puna për rritjen e kapaciteteve profesionale të administratës. Janë ofruar trajnime edhe pse në kushte pandemie për personelin e bashkisë. Krahasuar me një vit më parë mesatarja e ditëve të trajnimit për një punonjës është trefishuar.

INVESTIMET E BASHKISË	Fakt 2019	Fakt 2020	Fakt 2021	Plan 2021	Realizimi në %
Administrimi i bashkisë	2,588		5,304	8,217	65%
Në mijë Lekë					
Emërtimi i Projektit	Fakt 2019	Fakt 2020	Fakt 2021	Plan 2021	Realizimi në %
Krijimi i moduleve për sistemin e menaxhimit të taksave për shërbimet online				1,200	0%

Shërbime publike vendore

	Vlera në mijë Lekë	Pesha ndaj totalit në %	Realizimi Faktik 2021
Realizimi faktik 2021	321,396	22%	91%



Qëllimi i programit buxhetor

Përmirësimi i shërbimeve publike vendore për gjithë komunitetin e saj qoftë në qytet apo njësitë administrative

Figura 5: Kategoritë e shpenzimeve për programin Shërbime publike vendore: korente dhe investime

Trendi	Objektivat dhe Treguesit e Performancës	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
○	Raporti i sipërfaqes së gjelbëruar kundrejt sipërfaqes totale të bashkisë (në %)				
↑	Rrënjë pemë dekorative fondi i pemëve në hapësirat e gjelbërta (Ndryshimi vjetor në numër)	1,373	2,000	1,229	2,000
○	Shpenzime për përmirësimin e shërbimit të varrezave (Ndryshimi vjetor në %)				
○	Të ardhura nga tarifa e gjelbërimit kundrejt totalit të të ardhurave nga tarifat vendore (në %)	7	7		7
→	Trotuare (Ndryshimi vjetor në km linear)	1	1	0	0

Produkte	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
Rrënjë pemë të mbjella në vit	1,373	2,000	1,229	2,000
Sipërfaqe e gjelbëruar në vit në Km katrorë	1	1	1	1

Të dhëna	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
Sipërfaqe totale e gjelbër publike në Km2				
Sipërfaqe totale e bashkisë	806	806	806	806
Fondi total i pemëve dekorative / gjelbëruese të bashkisë	24,109	26,109	27,338	29,338
Trotuare në km linear	3	3	3	3
Të ardhura nga tarifa e gjelbërimit Në mijë lekë	23,404	21,734		29,674
Të ardhurat nga tarifat vendore Në mijë lekë	334,758	324,696		434,219
Shpenzime për përmirësimin e shërbimit të varrezave publike				


Performanca e shërbimit

Bashkia ka shpenzuar fonde për shërbimet publike të cilat përfshijnë gjelbërimin e hapësirave publike, shtimin dhe përmirësimin e trotuareve, mirëmbajtjen e varrezave publike mbi 320 milionë lekë, masën 92% të planit 2021, duke përfaqësuar kështu shërbimin më të rëndësishëm në buxhetin e bashkisë. Bashkia alokon rreth 22% të buxhetit të saj për këto shërbime. Performanca e këtij shërbimi tregon se:

- ✿ Është shtuar fondi i pemëve dhe bimëve dekoruese të ambjenteve publike të gjelbëruara nga bashkia
- ✿ Ruajtja e dhe mirëmbajtja e sipërfaqeve të gjelbërta publike nën administrimin e bashkisë
- ✿ Janë mirëmbajtur varrezave publike të bashkisë

Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor

Realizimi faktik 2021	Vlera në mijë Lekë	Pesha ndaj totalit në %	Realizimi Faktik 2021
	309,157	21%	98%



Qëllimi i programit buxhetor

Mirëarsimimi i popullatës nëpërmjet rritjes së frekuentimit të fëmijëve në sistemin arsimor parashkollor dhe atë bazë.

Figura 6: Kategoritë e shpenzimeve për programin Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor: korrente dhe investime

Trendi



Objektivat dhe Treguesit e Performancës

Numri i fëmijëve të regjistruar në sistemin parashkollor kundrejt numrit total të fëmijëve në moshën 3-6 vjeç (në %)

Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
55	54	59	

○	Numri mesatar i fëmijëve për çdo punonjës mësues (Raporti numrit të mësuesve kundrejt numrit total të nxënësve në arsimin bazë)	11	11		11
○	Numri mesatar i nxënësve në një klasë (Raporti numrit total të nxënësve kundrejt numrit total të klasave në arsimin bazë)	17	17		17
○	Raporti i shpenzimeve në institucionin e arsimit kundrejt numrit total të institucioneve të arsimit bazë dhe parashkollor (Mijë Lekë/institucion)	4,396	3,718		4,341

Produkte	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
Numri klasave funksionale në sistemin parashkollor	50	54		56
Numri klasave funksionale në sistemin arsimor bazë (arsimi 9 vjeçar)	370	374		376
Ndërtesa funksionale të arsimit parashkollor dhe atij bazë	71	72		73

Të dhëna	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
Fëmijë të regjistruar në sistemin parashkollor 3-6 vjeç	1,100	1,200		1,300
Numri i fëmijëve në moshën 3-6 vjeç	2,050	2,050		2,050
Numri i fëmijëve në moshën 5-6 vjeç	0	0		0
Mësues në sistemin parashkollor	144	150		152
Mësues në sistemin arsimor bazë (arsimi 9 vjeçar)	580	585		586
Nxënës në sistemin arsimor bazë (arsimi 9 vjeçar)	6,400	6,500		6,550
Total shpenzime në arsimin parashkollor dhe bazë Në mijë lekë	312,136	267,695	309,157	316,862

Performanca e shërbimit

Bashkia ka realizuar shpenzime për ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave arsimore të sistemit arsimor 9 vjeçar dhe atij parashkollor si edhe pagesën e edukatoreve të kopshteve, dhe punonjësve mbështetës të shkollave 9 vjeçare, mbështetje për transport, ushqim, strehim, kujdes mjekësor dhe dentar për fëmijët e shkollave, në masën 98% të planit 2021. Buxheti financon edhe mbështetjen për trajnimin e mëtejshëm të edukatoreve dhe mësuesve. Investimet të vogla në fonde kanë pasur realizim të vogël për shkak të rifokusimit në prioritetet e bashkisë përgjatë vitit 2020, ndërkohë që investimet e kryera përgjatë viteve të kaluara bëjnë që të shfrytëzohen ambientet e përmirësuar për të rritur cilësinë e shërbimit në shkollat 9 vjeçare të bashkisë. Bashkia shpenzon për financimin e këtij shërbimi rreth 21% të buxhetit të saj. Performanca e shërbimit gjatë vitit 2021 tregon se:

- ✱ Është rritur niveli i frekuentimit në sistemin parashkollor dhe atë bazë;
- ✱ Është ruajtur norma mesatare nxënës në klasë dhe nxënës për mësues;
- ✱ Është ruajtur i njëjti nivel i kostos mesatare të një institucioni arsimor duke ruajtur eficiencën e përdorimit të parasë publike për këtë shërbim

- Investimet e realizuara përgjatë viteve si edhe ato në vitin 2021 synojnë përmirësimin e kushteve të punës së mësuesve dhe nxënësve. Investimet u realizuan në masën 65% të planit. Ku vlen të përmendet shkolla në Voskopojë dhe Palestra e re për shkollën Nuci Naci në Korçë.

INVESTIMET E BASHKISË	Fakt 2019	Fakt 2020	Fakt 2021	Plan 2021	Realizimi në %
Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor	60,401	19,762	22,918	35,231	65%
Ne mijë Leke					
Emërtimi i Projektit	Fakt 2019	Fakt 2020	Fakt 2021	Plan 2021	Realizimi në %
Bashkëfinancim I projekteve për rikonstruksione të objekteve arsimore				11,489	0%
Rikonstruksion shkolla 9 vjecare Naim Frasheri, shtese per palester	5,086	21,147			
Rikonstruksioni i shkollës 9 vjeçare “Nuçi Naçi”, 3 kate shtesë për palestër	14,000	11,714	4,401	4,401	100%
Rindertim i shkolles 9 vjecare Voskopoje	22,233	2,413	7,604	7,604	100%

Menaxhimi i mbetjeve

Realizimi faktik 2021	Vlera në mijë Lekë	Pesha ndaj totalit në %	Realizimi Faktik 2021
	132,653	9%	117%




Figura 7: Kategoritë e shpenzimeve për programin Menaxhimi i mbetjeve: korente dhe investime

Qëllimi i programit buxhetor

Përmirësimi i mjedisit duke mirëmenaxhuar mbetjet urbane për të mbrojtur shëndetin e popullatës dhe krijuar kushte më të mira për shëndetin e popullatës.

Trendi	Objektivat dhe Treguesit e Performancës	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
↑	Buxheti për menaxhimin e mbetjeve kundrejt sasisë totale të mbetjeve të menaxhuar (Mijë Lekë për 1 tonë mbetje)	4,444	5,365	5,102	4,361
→	Frekuenca e grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve urbane në qytet dhe Nj.Administrative (Ndryshimi vjetor në herë)	0	0	0	0
→	Raporti i Popullatës së mbuluar me shërbim kundrejt totalit të popullatës (në %)	93	93	93	93
→	Raporti i territorit të mbuluar me shërbim kundrejt totalit të territorit në %	37	37	37	37
○	Raporti shuma totale e arketuar për shërbimin kundrejt shumës së faturuar nga klientët (në %)				
○	Raporti të ardhurave nga tarifa kundrejt shpenzimeve totale për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve (në %)	188	145		179

Produkte	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
Frekuenca e grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve urbane (mesatare Q+NjA)	5	5	5	5
Fekuenca në Qytet	7	7	7	7
Frekuenca në Njësitë administrative	3	3	3	3
Popullsia e mbuluar me shërbim	121,760	122,577	126,926	122,577
Popullsia e mbuluar me shërbim në Njësitë administrative	33,933	34,788	39,137	34,788
Popullsia e mbuluar me shërbim në Qytet	87,827	87,789	87,789	87,789
Sasia e mbetjeve në Njësitë administrative				
Sasia e mbetjeve në Qytet				
Sipërfaqe e mbuluar me shërbim (në km2)	685	685	685	685
Sipërfaqe e pastruar në vit (në km2)				

Të dhëna	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
Sipërfaqe totale e bashkisë Në km2	806	806	806	806
Buxheti për ofrimin e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve Në mijë lekë	84,435	102,621	132,653	113,378
Nga bizneset	75,486	69,985	0	84,612
Nga familjet	80,095	77,327	0	115,658
Popullsia totale nën administrimin e Bashkisë	130,243	131,274	131,274	131,274
Popullsia në Njësitë administrative	42,416	43,485	43,485	43,485
Popullsia në Qytet	87,827	87,789	87,789	87,789
Shuma totale e faturuar për shërbimin e menxhimit të mbetjeve Në mijë lekë				
Të ardhurat nga tarifat e shërbimit të mbetjeve Në mijë lekë	158,710	148,508		202,640

Performanca e shërbimit

Bashkia ka realizuar shpenzime për grumbullimin, transferimin dhe trajtimin e mbetjeve urbane në qytet dhe njësitë administrative si edhe pastrimin e rrugëve në pjesën urbane të bashkisë në masën

117% të planit buxhetor për vitin 2021. Bashkia shpenzon rreth 9% të buxhetit për këtë shërbim. Performanca e shërbimit tregon se:

- ✿ Është ruajtur frekuenca e tërheqjes së mbetjeve nga kazanat e grumbullimit që ka vendosur bashkia, 1 herë në ditë në zonën urbane dhe 3 herë në javë në zonën rurale;
- ✿ Bashkia aktualisht mbulon rreth 93% të popullatës me shërbim;
- ✿ Bashkia ka rritur grumbullimin e të ardhurave nga tarifa e shërbimit të pastrimit të qytetit duke arritur një normë arkëtimi më të lartë sesa shpenzimet operative për realizimin e shërbimit.
- ✿ Mbetjet bashkiake depozitohen në landfillin sanitar rajonal në Maliq, për këtë arsye kostot e transportit të shërbimit zënë një peshë të rëndësishme në ofrimin e shërbimit.

Sport dhe argëtim




Figura 8: Kategoritë e shpenzimeve për programin Sport dhe argëtim: korrente dhe investime

Qëllimi i programit buxhetor

Bashkia siguron përmirësimin e hapësirave argëtuese dhe sportive për ti mundësuar qytetarëve frekuentim në rritje të aktiviteteve sportive, ruatjen dhe transmetimin e traditës dhe kulturës për sportin dhe përfshirjen e angazhimin e të rinjve me sport.

Trendi	Objektivat dhe Treguesit e Performancës	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
○	Metra katror hapësira clodhëse dhe argëtuese (Ndryshimi vjetor në m2)	90,130	0		
○	Numri i biletave të shitura (Ndryshimi vjetor në %)				
○	Struktura për veprimtari sportive (Ndryshimi vjetor në numër)	10	0		
○	Të ardhura nga eventet sportive (Ndryshimi vjetor në %)		0		
○	Total shpenzime për veprimtarinë sportive kundrejt numrit total të banorëve rezidente (Mije leke/banor)	0	1		1

Performanca e shërbimit

Bashkia ka realizuar shpenzime për organizimin e aktiviteteve sportive, çlodhëse e argëtuese, zhvillimin dhe administrimin e institucioneve e të objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve, në shumën rreth 108 milion lekë në masën 101% të planit 2021. Bashkia shpenzon rreth 7% të buxhetit të saj për këtë shërbim. Investimet gjatë vitit 2021 kanë synuar përmirësimin e kushteve në disa ambiente sportive si edhe rikonstruksionin e pallatit të sportit Tamara. Performanca gjatë vitit 2021 tregon se:

- ✿ Janë mbështetur ekipet përfaqësuese të bashkisë në veprimtaritë sportive kombëtare dhe ndërkombëtare
- ✿ Janë përmirësuar shërbimet sportive
- ✿ Janë nxitur moshat e reja për t'u argëtuar dhe edukuar përmes sportit
- ✿ Është rritur numri i vizitorëve, të apasionuar pas sporteve në natyrë
- ✿ Është promovuar turizmi i aventurës, nëpërmjet zhvillimit të aktiviteteve sportive.

Produkte	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
Hapësira çlodhëse dhe argëtuese funksionale në m2	92,430	92,430		92,430
Struktura për veprimtari sportive funksionale	13	13		13

Të dhëna	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
Bileta të shitura në eventet sportive				
Popullsia e bashkisë	130,243	131,274		131,274
Shpenzime për mbështetjen e veprimtarive sportive Në mijë lekë	57,610	70,218		106,177
Të ardhura nga eventet sportive Në mijë lekë	63	63		63

INVESTIMET E BASHKISË	Fakt 2019	Fakt 2020	Fakt 2021	Plan 2021	Realizimi 2021 në %
Sport dhe argëtim	2,529	4,184	5,075	7,382	69%
Në mijë Lekë					

Emërtimi i Projektit	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021	Realizimi në %
Blerje mobilje dhe pajisje për qendrën e shërbimeve dhe kreativitetit	16,628				
Ndertimi i kompleksit Multifunksional Sportivo Kulturor	53,166				
Punime rrethimi tek Kompleksi Multifunksional Sportiv dhe Kulturor Korçe	1,389		180	180	100%
Qendra e Kreativiteti faza II				7,000	0%
Qendra e kreativitetit + shtese kontrate	36,313	39,207	1,613	20,444	8%
Rikonstrukcion I pallatit të sportit "Tamara Nikolla"			3,512	5,679	60%
Riorganizimi i sheshit te hyrjes se Qendres Multifunksionale Kulturore dhe Sportive			879	880	100%
Shtese ambjente ekspozuese skulpturash "Parku Rinia"			1,462	1,462	100%

Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore

	Vlera në mijë Lekë	Pesha ndaj totalit në %	Realizimi Faktik 2021
Realizimi faktik 2021	68,607	5%	90%




Figura 9: Kategoritë e shpenzimeve për programin Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore: korente dhe investime

Qëllimi i programit buxhetor

Bashkia zbaton politika të mbrojtjes së trashëgimisë kulturore dhe organizimin e eventeve artistike dhe kulturore, për të përmirësuar jetën kulturore në komunitet

Trendi	Objektivat dhe Treguesit e Performancës	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
↑	Fonde buxhetore të shpenzuara për një institucion të trashëgimisë kulturore – raporti fonde buxhetore kundrejt numrit total të institucioneve të trashëgimisë Mijë Lekë / institucion	0.0	1.0	0.7	
○	Numri i biletave të shitura (Ndryshimi vjetor në %)	83.9	-70.0		
↑	Numri i shfaqjeve kulturore; artistike të mbështetura me fondet e bashkisë (Ndryshimi vjetor në numër)	-2	-15	5	
○	Rritja e të ardhurave nga muzetë, teatrot, eventet kulturore, kopshtet zoologjike; botanike etj (Ndryshimi vjetor në %)		-75.4		

Produkte	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
Institucione të trashëgimisë kulturore funksionale	3.00	4.00	5.00	5.00
Shfaqje kulturore; artistike të mbështetura me fondet e bashkisë	45.00	30.00	35.00	47.00

Të dhëna	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
Bileta të shitura për evente kulturore të organizuara nga bashkia	16,651	5,000	0	7,000


Buxheti alokuar për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore Në mijë lekë	125,674	96,969	68,607	75,987
Të ardhurat nga muzetë, teatrot, eventet kulturore Në mijë lekë	5,336	1,312	0	1,760

Performanca e shërbimit

Bashkia ka realizuar shpenzime për organizimin e eventeve artistike si edhe ruajatur, mirëmbajtur dhe operuar institucione të trashëgimisë kulturore në masën 90% të planit 2021. Bashkia shpenzon rreth 5% të buxhetit të saj për këtë shërbim. Performanca e shërbimit do të përmirësohet duke realizuar:

- ✿ Ritur numrin e shfaqjave / eventeve artistike të organizuara nga bashkia duke i dhënë jetë komunitetit sidomos në këto kohë kaq të vështira pandemie
- ✿ Përmirësuar efieciën e përdorimit të parasë publike për mirëmbajtjen dhe operimin e institucioneve të trashëgimisë kulturore
- ✿ Shtuar të ardhurat nga aktiviteti i institucioneve të trashëgimisë kulturore, etj.

Ndriçim rrugësh



Qëllimi i programit buxhetor

Bashkia ofron sigurinë në komunitet nëpërmjet ndricimit të hapësirave publike

Figura 10: Kategoritë e shpenzimeve për programin Ndriçim rrugësh: korente dhe investime

Trendi	Objektivat dhe Treguesit e Performancës	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
↑	Raporti sipërfaqe e mbuluar me ndriçim kundrejt totalit të sipërfaqes publike të bashkisë (në %)	16.1	16.4	31.0	31.0
↑	Shpenzime operative dhe mirëmbajtje plus investime për ndricimin e hapësirave publike kundrejt sipërfaqes totale të ndriçuar (Mijë Lekë të shpenzuara për 1 kilometer katror hapësirë publike të ndriçuar)	471.0	452.7	238.5	314.4
→	Të ardhura nga tarifat për ndriçimin e hapësirave publike kundrejt totalit të shpenzimeve të bashkisë për mbulimin me ndriçim të hapësirave publike (raporti në %)	57.6	55.1		59.2

Produkte	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
Sipërfaqe e hapësirave publike e mbuluar me ndriçim Në ha	130.0	132.0	250.0	250.0

Të dhëna	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
Shpenzime për ndriçimin e hapësirave publike Në mijë lekë	61,231	59,759	59,624	78,610
Sipërfaqe publike e bashkisë (total sipërfaqe) Në ha	806	806	806	806
Të ardhura nga tarifat për ndriçimin e hapësirave publike Në mijë lekë	35,296	32,906		46,506

Performanca e shërbimit

Bashkia ka realizuar shpenzime për ndricimin e hapësirave publike në masën 76% të planit 2021. Bashkia shpenzon rreth 4% të buxhetit të saj për këtë shërbim i cili kryesisht mbulon energjinë elektrike, por këto vitet e fundit edhe investimet e reja për zgjerimin e rrjetit ndricues në gjithë territorin e urbanizuar të bashkisë. Performanca e shërbimit gjatë vitit 2021 tregon se:

- ✿ Është dyfishuar sipërfaqja publike e bashkisë e mbuluar me ndricim. Sot llogaritet se mbi 30% e territorit ndricohet. Duke zënë kështu një nga bashkitë më të mirëmbuluara me ndricim në të gjithë vendin
- ✿ Është përgjysmuar kostoja e ndricimit të një km² sipërfaqe publike

Të ardhurat nga tarifat e ndricimit zënë mbi 50% të koston së ndricimit publik, duke përfaqësuar edhe njëherë një nga mbulimet më të larta në rrang vendi të këtij shërbimi. Synimi i bashkisë është që të arrijë të mbulojë tërësisht koston e këtij shërbimi nga tarifa.